




**Deklaratat e analizuara:**  
**16 Deklarata të analizuara**  
(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri  
Periodik/Vjetor 2018)


**Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018**



Pasuria para fillimit të detyrës është 0;  
Pasuria bruto me datë 31.12.2018 është  
5,855,642 lekë.

+ 390,376 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

**Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive**  
Vlera në Lekë



**Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese**

Të Ardhurat 2004-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	16,252,820	60.6%
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	5,757,954	21.5%
Të ardhura nga Qira	3,926,400	14.6%
Të ardhura nga Mësimdhënia	807,000	3.0%
Të ardhura të tjera	74,280	0.3%
<b>Total</b>	<b>26,818,454</b>	<b>100%</b>

**Kontrolli Aritmetik dhe Logjik**

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:  
**1 deklaratë Me Probleme**  
**14 deklarata Pa Probleme**

Në vitin 2007, subjekti deklaroi aset shtesë një zyrë në Gjirokastrë me sipërfaqe 45 m<sup>2</sup> dhe vlerë 18,000 euro, ku 3,600 euro mbetet si detyrim i papaguar firmës. Si burim financimi për këtë pasuri, subjekti deklaroi 750,000 lekë kursime të akumuluar ndër vite, por të padeklaruara më parë, ndaj rezultoi me burime të pamjaftueshme në vlerën e 51,552 lekëve. Kjo zyrë do të jepet më vonë me qira duke gjeneruar të ardhura prej 3,926,400 lekësh në total. Gjatë viteve subjekti deklaroi shtesa asetesh truall në Gjirokastrë, Sarandë dhe Dropull në vlerë totale 463,336 lekë.